



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Maj 2021

Nr: 355

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit, për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës sh.a.

Kërkues: Partia Demokratike

Ndaj: Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës sh.a

Baza ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar gjatë procesit të hetimit administrativ:

VËREN:

I. Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një denoncim në ndërfaqen e “Aktiviteteve të Ndaluar”, në rubrikën “Kallëzo”, nga subjekti politik Partia Demokratike, për shkelje të parashikuar në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas denoncimit të raportuar më datë 1.4.2021, me numër identifikimi të gjeneruar nga sistemi ID nr. 2731, në ndërfaqen e KQZ-së pretendohet se: “Në kundërshtim me Kodin Zgjedhor



dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës, sh.a institucion në varësi të bashkisë Vau Dejës, qarku Shkodër, është përfshirë në fushatë duke propaganduar lajme në favor të qeverisë. Kjo veprimtari bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, konkretisht: Neni 3, pika 1/1, shkronja “a”, pika 1/3, shkronjat “c” dhe “ç”.

Bashkëlidhur denoncimit dhe linku në faqen e Facebook-ut të Kryeministrit.

Sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e fakti

Komisioni Rregullator në KQZ me datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Ky akt normativ ka hyrë në fuqi menjëherë pas miratimit të tij dhe është publikuar në faqen zyrtare të KQZ-së në datë 26.12.2020.

Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin në ndërfaqen e raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa pika 5 e këtij vendimi sanksionon se subjektet raportuese mund ta dërgojnë raportimin nëpërmjet e-mail-it zyrtar në adresën raportime.institucione@kqz.gov.al ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar. Momenti i aksesit në



ndërfaqe, momenti i dërgimit të e-mail-it ose momenti i mbërritjes së postës në zyrat e Komisionerit.

Sipas përcaktimeve të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator “Veprimtari publike”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

➤ Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3614 prot., datë 11.4.2021, ka kërkuar informacion bashkisë Vau Dejës në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti.

➤ Me shkresën nr. 2397/1 prot., datë 16.4.2021, protokolluar në KQZ me numër 3614/1, datë 20.4.2021, bashkia Vau Dejës ka sqaruar se:

“Bashkia Vau Dejës nuk ka informacion të vërtetuar sipas së cilës rezulton se Drejtori i Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës sh.a, ka propaganduar lajme në favor të qeverisë. Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës sh.a ka kryer vetëm aktivitete normale të punës së saj programuar që më parë”.

III. Analiza ligjore

Neni 3, pika 1.1, shkronja “a” e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikon se: veprimtari të ndaluara për tu promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;

Neni 3, pika 1.3, shkronja “c”, “ç”, e vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator parashikon se, “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

- c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;



ç) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në vlerësim të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, konstaton se, nuk rezultoi e provuar se Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës sh.a, është në shkelje të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.

Neni 3, pika 1.1, shkronja “a”, kufizon fushën e veprimit në ato veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Referuar neni 3, pika 1.3, shkronja “ç”, në mënyrë të tillë që të jemi në kushtet e zbatueshmërisë së kësaj dispozite, duhet që:

- Të përdoren në mënyrë të detyruar në fushatë zgjedhore administrata e institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.

Nga provat e vëna në dispozicion nga denoncuesi nuk u provua se kemi të bëjmë me veprimtari publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve.

Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës sh.a, ka hartuar planin e investimit për zhvillimin e shpërndarjes së rrjetit, gjatë hartimit të planit, ka marrë në konsideratë zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes dhe planifikimit urban dhe rajonal për zonën ku do të zhvillohet sistemi i shpërndarjes si dhe kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektime në terren lidhur me ofrimin e një sistemi shpërndarës të sigurt, mbarëvajtjen e të gjithë kushteve teknike në mënyrë sigurimin e aksesit të pandërprerë të furnizimit me ujë.



Në këtë rast, kjo është një veprimtari administrative rutine e Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a, si inspektimi në terren me qëllim mirëmbajtjen dhe riparimin periodik për të pasur një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm.

Gjatë analizës së fakteve dhe provave të paraqitura, çmohet se aktiviteti është një veprimtari administrative e Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a, në ushtrim të detyrave dhe funksioneve të parashikuara nga aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a kryen veprimtarinë e saj. Kryerja e këtyre detyrave, nga punonjësit e Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a, nuk përbën përdorim të tyre për qëllime zgjedhore. Për këto arsye vlerësoj se nuk jemi në ndalimin e parashikuar në nenin 3, pika 1.1, shkronja “a”, pika 1.3 shkronja “c” dhe “ç” të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ

Neni 92 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, përcakton detyrimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.

Referuar aktivitetit të publikuar në faqen e Facebook-ut të Kryeministrit, kjo veprimtari është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datë 28.3.2021 nga Kryeministri sipas parashikimeve të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator, dhe rrjedhimisht pjesëmarrësit nuk mbartin detyrimin e raportimit të dyfishtë për sa kohë që aktiviteti është raportuar nga organizuesi i tij.

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ për kallëzimin e kryer nga Partia Demokratike e Shqipërisë, pasi në përfundim të hetimit administrativ rezulton se, veprimtaria e Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a, nuk përmban fakte dhe rrethana që përfshihen në fushën e zbatimit të ndalimeve të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, pika 2, 91, 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015



“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S :

1. Përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës sh.a për arsye se nuk konstatohen elemente të shkeljes së dispozitave të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

